

UNICEF
SHQIPËRI

PROJEKTI CLEEN- FLETORJA E NXËNËSIT


KLASA E KATËRT

Pergatitur nga: Raiha Idrees

Emri im është _____

Une dua që Shqipëria ime të jetë e bukur dhe e pastër

UJI



**PËRDORENI
UJIN
ME KUJDES**

Tema : Pastrimi i ujit

Aktiviteti #: Një

Aktiviteti: Të bëjmë një filtër uji

Materiale: Një shishe plastike e ndarë më dysh (nga një i rritur), letër kuzhine, zhavorr, rërë dhe rul pambuku për filterin, ujë i ndotur (mund ta ndotni me vaj dhe ngjyruet ushqimor, copa letrash dhe copa të vogla buke peshku).

Hapi fëmijë-fëmijë: Të kuptuarit

1. Vendosni gjysmën e sipërme të shishes mbrapsht (në formë hinke) brenda gjysmës së poshtme. Gjysma e sipërme do të shërbejë për të bërë filterin, kurse gjysma e poshtme do të mbledhë ujin e filtruar.
2. Shtroni materialin e filterit brenda gjysmës së sipërme të shishes transparente. Në vartësi të ndotjes që mund të mbajnë materialet e filtrimit, mendoni për rradhën e vendosjes së tyre në hinkën e improvizuar. Do të ishte një sfidë e vërtetë nëse do të mund ta filtronit ujin vetëm me dy materiale filtrimi.
3. Hidheni ujin e ndotur në filtër. Si ju duket uji pasi është filtruar?
4. Hiqini materialet e filtrit dhe shikoni shtresat e ndryshme të tij. A mund të dalloni se cilët nga ndotësit kanë mbetur në secilën prej shtresave të filtrit të vendosura prej jush?
5. Pastrojini pjesët e shishes dhe bëjeni edhe një herë eksperimentin. Vendosini materialet e filtrimit në rradhë tjetër ose përdorni lloje të tjera materialesh në sasi të ndryshme.

Tema: Uji dhe gjallesat e tij

Aktiviteti #: Dy

Aktiviteti: Të provojmë se pemët kanë nevojë për ujë

Materiale: vazo, ujë, ngjyrues ushqimor (ngjyrë e errët), lule me ngjyrë të çelët

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve

1. Mbusheni vazon me ujë dhe shtoni bojë ushqimi.
2. Gjeni një lule me ngjyrë të çelur dhe vendoseni në vazo.
3. Lëreni aty gjatë gjithë natës.
4. Ditën tjetër shikojeni lulen.
5. Çfarë vini re?
6. Vizatojeni lulen përpara dhe pas eksperimentit. Shkruani metodën dhe rezultatin e eksperimentit që bëtë.
7. Shkruani përfundimin që nxorrët nga ky eksperiment.

Tema: Llojet e Ujit

Aktiviteti #: Tre

Aktiviteti: të shkruajmë një tregim

Materiale: Laps dhe letër

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi

Shkruani një tregim për vendin më të kripur në botë. Ku gjendet ky vend? A mund të krijoni një tregim për një vend të tillë?

Tema: Burimet e ujit

Aktiviteti #: katër

Aktiviteti: Të shënojmë burimet e ujit në Shqipëri

Materiale: Hartë e Shqipërisë, shënjes me ngjyrë blu ose laps me ngjyrë

Hapi fëmijë-fëmijë: Përsëritje

Vizatoni hartën e Shqipërisë. Zbuloni ku janë burimet e ndryshme ujore, lumenjtë, liqenet, detrat, etj., që burojnë e derdhen brenda e jashtë vendit tonë. Vizatoni dhe emërtoni burimet e ujit në hartë. Ngjyrosni me ngjyrë blu burimet e ujit.



AJRI



Tema: Ajri

Aktiviteti #: Një

Aktiviteti: Të bëjmë mullinj me erë ose flamuj.

Materiale: Skedë e ngjyrosur, shkop i hollë rreth 30 cm i gjatë (të mos çahet nga ngulja e një gozhde të vogël), një rruazë, një gozhdë e një kopsë ose thumb me kokë të madhe, njiqitës, çekiç.

Hapi fëmijë-fëmijë: Të kuptuarit

Ç'është mulliri me erë?

Mulliri me erë është një makinë që shfrytëzon erën për të krijuar energji duke rrotulluar një rrotë me pllaka ose me vela. Kur rrotullohet rrota, ve në lëvizje një bosht, mekanizma dhe kuzhineta që i japin energji makinës. Mulliri me erë në fermën e Miçiganit që shikoni në foto duhet të jetë përdorur për të nxjerrë ujë nga nëntoka në shekullin e 19-të dhe në fillim të shekullit të 20-të. Do të ishte më e saktë të quhej "pompë me erë", por njerëzit e quajnë "mulli me erë".

Mullinjtë me erë janë përdorur për qindra vjet me rradhë për t'u dhënë energji makinave që përdoreshin për të bluar grurë e misër. Në ditët tona, kemi mullinj me erë i quajmë "turbina me erë" dhe që i përdorim për të prodhuar energji elektrike.

Cili vend është i njohur për përdorimin e mullinjve të erës?

Njerëzit në Hollandë përdornin mullinj me erë për të bluar shumë gjëra: grurë, misër, gëlqere, allçi, kakao dhe erëza. Ata përdornin erën si energji për të vënë në lëvizje mullirin dhe makina të tjera në fabrikat e prodhimit të pëlhurës.


Hollandezët që përdornin diga për të mbrojtur nga përmytja tokat e tyre që janë nën nivelin e detit, i përdorin mullinjtë e erës për të prodhuar energji për pompat që nxirrin ujin nga toka dhe e hidhnin në kanale ku mund t'u shërbente për punë të tjera, në vend që t'i dëmtonte.

Për këtë aktivitet duhet një i rritur për të bërë vrimat dhe për të ngulur gozhdat në shklop.




Udhëzues për të bërë një mulli të vogël me erë

- Pritni një katror letre me përmasa 20cm x 20cm, (për të bërë një mulli me dy ngjyra siç tregohet më lart, prisni dy katrorë letre me ngjyra të ndryshme dhe ngjitii bashkë).
- Vizatoni diagonalet dhe priteni katrorin përgjatë tyre me drejtim nga brenda për rreth 11 cm nga secili cep, siç tregohet në figurën anash.
- Bëni pesë vrima në katror, një në çdo cep dhe një në mes si në figurën djathtas lart. Vrimat e cepave duhet të jenë të mëdha aq sa të lejojnë rrotullimin, por jo shumë të mëdha, që koka e gozhdës të mos dalë jashtë tyre.



- Kthejeni secilin cep me vrimën nga brenda dhe, duke përdorur një gozhdë me kokë të madhe (nëse nuk keni gozhdë me kokë të madhe, shkoni në gozhdë një kopsë të vogël) bashkojini vrimat e cepave me vrimën e mesit. Tani mulliri me erë duhet të ketë marrë formën që tregohet në figurën përmbri.
- Kaloni rruazën në gozhdë nga pas mullirit që ai të rrotullohet lehtësisht pa u fërkuar me shklop.

- Me një çekiç, nguleni gozhdën në shkop. Nëse gozhda ju del jashtë shkopit, shtypeni dhe mbulojeni me pak ngjitës pas shkopit.
- Lërimi fëmijët ta provojnë mullirin duke i fryrë nga të gjitha anët për të parë nga cili drejtim rrotullohet më kollaj dhe më shpejt.
- Dilni jashtë me mullinjtë nëse ka erë dhe provojini si punojnë. Kthejini nga të gjitha anët për të parë nga cila anë rrotullohen më mirë dhe nga cili drejtim priren të rrotullohen më shumë.
- Nëse nuk ka shumë erë, lërimi fëmijët të vrapojnë me to në dorë apo t'i rrotullojnë me shpejtësi duke qëndruar në vend për të parë se ç'ndodh.



Flamujt

Aktivitet i thjeshtë për të parë efektin e erës.

Do t'ju duhen:

Kallama ose shkopa të gjatë.

Materiale të holla (Pambuk ose lino e hollë)

Ngjitëse



- Priteni materialin në forma të ndryshme (drejtëkëndësh, trekëndësh, etj.).
- Ngjiteni materialin në njërën anë të kallamit, duke e rrotulluar derisa të mos duket kallami dhe copa ta ketë mbulaur plotësisht. Lërimi derisa të thahet ngjitësja.
- Nxirrini flamujt jashtë për të parë sesi valëviten në erë. Vini re cili nga materialet valëvitet më mirë.
- Ulini flamujt afër tokës dhe pastaj ngrijini prap lart për të parë nëse ka ndryshime.
- Lërimi flamujt jashtë dhe mbani shënim çdo ditë nëse do të valëviten apo jo, dhe në ç'drejtim do të valëviten.

Tema: Ajri

Aktiviteti #: Dy

Aktiviteti: Sa është kostoja e pirjes së duhanit?

Materiale: letër, laps, ngjyra, tabakë letre.

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve

Ata që pijnë duhan shpenzojnë para për të blerë cigare. Gjeni disa njerëz që pijnë duhan në lagjen tuaj. Pyetini sa para shpenzojnë për të blerë cigare në një javë. Llogaritni sa para bëhen në një muaj, në një vit dhe në 10 vjet. Mendoni sa shumë gjëra këta njerëz mund të kishin blerë me këto para që shpenzojnë në një javë, në një muaj, në një vit dhe në dhjetë vjet për të blerë duhan. Në një tabelë tregoni kursimet që mund të kishin ruajtur dhe çfarë mund të kishin blerë, po të mos i kishin harxhuar paratë me cigare. Mund të shprehni mendimet tuaja në një shkrim apo në një vizatim, por duhet të tregoheni sa më krijues në prezantimet që do të bëni.

Tema: Ajri

Aktiviteti#: Tre

Aktiviteti: Anketim i atyre që pijnë duhan dhe i atyre që nuk e pijnë.

Materiale: letër, laps, letër grafiku (sipas dëshirës) lapsa me ngjyra

Hapi fëmijë- fëmijë: Zbulimi i fakteve

1. Zgjidhni 15-20 njerëz në mënyrë rastësore.
2. Bëni një anketim të thjeshtë nëse pijnë duhan apo jo, apo pijnë vetëm nganjëherë.
3. Nga të dhënat që do të mblidhni, bëni një grafik që të ilustroni faktet që keni zbuluar.
4. Paraqitini të dhënat në një tabelë dhe vërtetini titull tabelës që do të krijoni.

Tema : Ajri

Aktiviteti #: Katër

Aktiviteti: Nëse do të mund të flisja me erën, çfarë do t'i thosha asaj?

Materiale: Laps, letër

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi

Tani keni rastin të tregoni krijimtarinë tuaj! Nëse do të mund të flisnit me erën, çfarë do t'i thoshit asaj? Nëse do të ishit erë, çfarë do të shihnit? Çfarë do të bënit? Ku do të shkonit? Si do të ndiheshit? Shkruani një ese me temën "Nëse do të mund të flisja me erën, ja çfarë do t'i thosha" ose "Nëse do të isha erë, ja se çfarë do të bëja"

Tema: Ajri

Aktiviteti #: Pesë

Aktiviteti: Të bëjmë një poster për mospirjen e duhanit.

Materiale: Letër poster, shënjes, laps, ngjyra

Hapi fëmijë-fëmijë: Përsëritje

Bëni një poster që t'i nxisni njerëzit të mos pijnë duhan. Si do ta jepnit këtë mesazh? Kujt i drejtohet posteri: të rriturve, të rinjve, adoleshentëve apo fëmijëve të shkollës? Çfarë ngjyrash do të përdorni? Çfarë do të vizatoni?

TOKA



Tema : Toka

Aktiviteti #: Një

Aktiviteti: Studimi i dheut

Materiale: Mushama tavoline, kavanoz me kapak, lugë, dhe, kanë me ujë, letër kuzhine, lente zmadhuese.

Hapi fëmijë-fëmijë: Të kuptuarit



Studimi i dheut është një projekt shkencor që u mëson nxënësve të studiojnë shtresat e ndryshme të tokës.

Si ta zhvillojmë projektin shkencor për studimin e dheut?

Hapi 1: Mbuloni vendin ku do të punoni. Mbushni kavanozin përgjysëm me dhe. Shtoni ujë deri afër grykës. Vërinë kapakun dhe shtrëngojeni mirë që të mos hapet.

Hapi 2: Tundeni kavanozin fort për 30 sekonda dhe më pas vendoseni diku. Lëreni kavanozin në qetësi derisa uji dhe dheu të ndahen. Dheu do të krijojë shtresa.

Hapi 3: Shikoni shtresat me kujdes dhe mendoni ç'mund të thoni për to. Sa shtresa shikoni? Cila nga shtresat përbëhet nga grimcat më të mëdha? Cila nga shtresat ka grimcat më të vogla? A e merrni dot me mend pse?

Hapi 4: Për të studjuar më tej shtresat e ndryshme dhe përbërjen e tyre, ju mund të nxirrni një pjesë të shtresave dhe t'i shikoni me kujdes. Përdorni një lugë për të nxjerrë dheun nga kavanozi. Vendoseni dheun që do të nxirrni mbi një copë letre kuzhine.

Hapi 5: Pastaj derdhni me kujdes ujin e fillimit dhe me lugë nxirrni jashtë kavanozit një pjesë nga shtresa tjetër e dheut në kavanoz. Vendoseni edhe atë në një tjetër letër kuzhine. Përsëriteni veprimin, nëse ka shtresa të tjera.

Hapi 6: Pasi secilën nga shtresat ta keni nxjerrë mbi letrat e kuzhinës, shikojini ato me lente zmadhuese. Ç'farë tjetër mund të thoni për shtresat e dheut pasi i keni parë me kujdes?

Hapi 7: Ju mund ta bëni këtë eksperiment me dhe të marrë nga vende të ndryshme dhe të krahasoni zbulimet që do të bëni. Vizatoni kavanozin plot me dhe pasi e keni tundur, përsëri pasi dheu dhe uji janë ndarë dhe krahasoni vizatimet.

Tema: Toka

Aktiviteti #: Dy

Aktiviteti: Cilat kafshë që janë në zhdukje e sipër jetojnë në vende të ndryshme të botës?

Materiale: Hartë e botës, etiketa, ngjitëse, gërshërë

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve

Zbuloni disa nga kafshët që janë në zhdukje e sipër. Vendosni etiketa me emrin e vendeve ku gjenden këto kafshë në hartën e botës. Kush gjeti më shumë kafshë të rralla, ju apo shokët tuaj? Tregojani posterin shokëve dhe njerëzve të shtëpisë. Ç'mendojnë ata për këtë problem. Ç'mund të bëni ju që këto kafshë të mos zhduken?

Tema: Toka

Aktiviteti #: Tre

Aktiviteti: Të bëjmë një kartolinë për nder të tokës

Materiale: skedë 8X11 cm, shenjues, pullë poste, penë, adresë.

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi

A e dini çfarë janë kartolinat? Nëse jo, shkoni në një librari dhe shikoni kartolinat e ndryshme që shiten atje. Tani bëni një kartolinë për tokën. Nga një letër poster, prisni një letër për kartolinën tuaj me përmasat që doni. Vizatoni një pamje dhe shkruani mesazhin që doni të jepni në lidhje me tokën. Një mesazh i tillë mund të jetë: "SHPËTONI TOKËN" ose "SA E BUKUR ËSHTË TOKA". Nëse doni mund të bëni më shumë se një kartolinë. Tani mendoni se kujt doni t'ia çoni kartolinën që bëtë. Shkruani mesazhin. Shkruani adresën dhe vendosni pullën mbi kartolinë. Tani mund ta postoni dhe të prisni kur t'ju njoftojnë se e morën. A do t'ju përgjigjen me një kartolinë të tyre? Të shohim!

Tema: Toka

Aktiviteti #: Katër

Aktiviteti: Shkruani një tregim me temën "Të shpëtojmë Planetin Tokë"

Materiale: Letër dhe laps.

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi

Toka është në rrezik. Bimët dhe kafshët po zhduken. Natyra po vdes ngadalë dhe fushat po thahen. Çfarë mund të bëni ju? Si mund të ndihmoni? Shkruani një tregim për mënyrën se si do të mund ta shpëtonit ju planetin Tokë. Çfarë do të bënit? Mendoni se do të jepnin rezultate positive masat që do të merrnit?

Tema : Toka

Aktiviteti #: Pesë

Aktiviteti: Të bëjmë një kopësht të vogël zoologjik

Materiale: kuti kartoni, piktura kafshësh të prera nga revista dhe gazeta të vjetra, ngjitëse, gërshtë, materiale të riciklueshme për kafaz, letër.

Hapi fëmijë-fëmijë: Përsëritje



Edhe ju mund të bëni një model kopështi zoologjik. Prisni anën e një kutie kartoni. Me letër më ngjyrë mund të bëni barin dhe rërën. Prisni figurat e kafshëve nga revistat dhe gazetatat dhe ngjitini në kuti. Mund t'i përforconi duke i ngjitur më parë në karton. Tregohuni sa më krijues dhe sa më origjinalë me kopshtin tuaj zoologjik. Më lart janë dhënë disa shembuj për t'ju krijuar një ide.

NATYRA



Tema: Natyra

Aktiviteti #: Një

Aktiviteti: Kolazh i natyrës

Materiale: revista të vjetra, ngjitëse, gërshërë

Hapi fëmijë-fëmijë: Të kuptuarit

E dini ç'është kolazhi? Është një përzierje e figurave të ndryshme të vendosura bashkë për të dhënë një mesazh të rëndësishëm. A mund të bëni një kolazh tuajin duke përdorur revista dhe gazeta të vjetra për të dhënë mesazhin se Shqipëria, vendi ynë, është një vend shumë i bukur?

Tema: Natyra

Aktiviteti #: Dy

Aktiviteti: Natyra në Shqipëri

Materiale: Hartë e Shqipërisë, letër, spango me ngjyrë, ngjitës, shënjes, skeda

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve

1. Në një letër poster, vizatoni hartën e Shqipërisë dhe ngjyroseni atë.
2. Mësoni për pikat e ndryshme natyrore të vendit tonë.
3. Në skeda të veçanta, shkruani disa fjali për secilën pikë natyrore. Nëse doni, mund edhe të vizatoni skedat.
4. Gjeni në hartë këto vende dhe shënojin.
5. Duke përdorur spangon e ngjyrosur, varni skedën në hartë në vendin që përshkruajnë fjalitë që keni shkruar. Në këtë mënyrë skeda do të japë informacion pikërisht për atë vend të natyrës shqiptare.
6. Tregojuani hartën shokëve dhe njerëzve të shtëpisë.
7. Çfarë thanë ata? A u çuditën që kaq shumë pika natyrore të bukura gjenden në Shqipëri? Po ju vetë a jeni i çuditur?

Tema: Natyra

Aktiviteti #: Tre

Aktiviteti: Të krijojmë një mundësi për ushqimin e zogjve

Materiale: Boçe pishe, gjalpë kikiriku, fara zogjsh, spango, tasa palstikë, hapëse vrimamsh, puding zogjsh, lugë

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi



Me boçet e pishave mund të krijojmë mundësi për ushqimin e zogjve. Me një lugë lyejmë boçen me gjalpë kikiriku. Më pas e rrotullojmë në një vend ku kemi hedhur fara zogjsh. E lidhim dhe e varim jashtë për zogjtë.

Për të hedhur ushqim për zogjtë në një tas të vogël plastik, hapni tre vrima në distancë të barabarta në buzët e tasit. Mbusheni tasin me fara zogjsh dhe me spongon që do ta kaloni tek vrimat, vareni jashtë në një pemë që ta gjejnë zogjtë.

Edhe vëllezërit dhe motrat tuaja më të vogla, me ndihmën tuaj, mund të krijojnë mundësi ushqimi për zogjtë në dimër. Për shembull, përpiquni që në vend të tasave të përdorni gjysmat e qitrove apo të portokalleve, për t'i mbushur me fara zogjsh.

Riciklojeni një pemë të vjetër krishtlindjesh për zogjtë duke e vënë në oborrin e shtëpisë. Në degët e saj varni ushqim për zogjtë. Varni edhe gjëra të tjera si bukë të mbetur, apo fruta nga pemët e pyllit. Kalojini kokoshkat dhe frutat e pyllit në fije dhe përdridheni fillin në pemë që të duket bukur dhe të afrohen zogjtë për t'i ngrënë.

Tema: Natyra

Aktiviteti #: Katër

Aktiviteti: Ne dhe Natyra (Fjalëkryq)

Materialet: -

Hapi Fëmija për Fëmijën: Përsëritja


Horizontalisht

3. Trupi i zjarrtë qiellor që gjendet në qendër të sistemit tonë të planetit dhe që është burim drite e ngrohtësie.
5. Lëng pa ngjyrë, pa erë, i përbërë nga oksigjeni dhe hidrogjeni, që bie si rreshje, që mbush përrenjtë, lumenjtë, liqenet e detet, përdoret për t'u pirë, për të larë etj.
7. Vija rrethore më e largët në hapësirë deri ku arrin vështirimi ynë, vija ku duket sikur puqet qielli me tokën ose me sipërfaqen e ujërave.
9. Rrymë ajri që lëviz në drejtime të ndryshme.
11. Pjesë toke e ngritur si breg i lartë me pjerrësi të butë; mal i ulët nën një mijë metra dhe me shpatë të buta.
12. Vend shumë i ngritur mbi sipërfaqen e tokës që ka përreth, më i lartë se kodra, me majë a me kreshtë dhe me shpatë zakonisht të pjerrëta, që zbresin në lugina.


Vertikalisht

1. Rreshje që formohet nga kthimi i avujve të atmosferës në ujë gjatë ftohjes dhe që bie pika-pika nga retë në tokë.
2. Pamje e natyrës a e një vendi që kapet nga syri, pamja e natyrës që na del para sysh.
4. Vend i rrafshët, i hapur a i gjerë në natyrë, pa male e pa kodra dhe zakonisht pa pyje; hapësirë natyrore e sheshtë.
6. Dru, shkurre, barishte, lule, kërpudhë a qenie tjetër e këtij lloji, që mbin, rritet e jeton zakonisht e ngulur në një vend, që e merr ushqimin nga toka dhe nga ajri me rrënjë e me gjethe dhe që shumëzohet me fara ose me lastarë; që rriten në tokë ose në ujë.
8. Gjithësia me tërë sendet dhe qeniet, e cila zhvillohet sipas ligjeve të caktuara, bota organike dhe joorganike.

10. Rreshje atmosferike, që bie nga retë flokë-flokë në trajtë kristalesh të bardha; shtresa e bardhë e këtyre flokëve, që mbulojnë vendin aty ku bien.



Për zgjidhjen shikoni fletën pasardhëse



NDOTJA




Tema: Ndotja

Aktiviteti #: Një

Aktiviteti: Poster për ndotjen

Materiale: Shënjes, letër për grafik, laps dhe bojë.

Hapi fëmijë-fëmijë: Të kuptuarit



Posterat janë një mjet shumë i mirë për të ndërgjegjësuar njerëzit në lidhje me një çështje të rëndësishme. Hartoni një poster për një nga llojet e ndotjes. Sigurohuni që mesazhi juaj mjedisor të jetë i ilustruar qartë dhe posterit të japë një mesazh të qartë për ndotjen. Pasi të keni filluar, tregojuni posterin shokëve dhe njerëzve të shtëpisë.

Tema: Ndotja

Aktiviteti #: Dy

Aktiviteti: Anketë për ndotjen

Materiale: Letër, laps, ngjyra, letër për grafik

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve

A e dini çfarë është një grafik në formë torte? Ato janë shumë të dobishëm për të vlerësimin e situatave të caktuara. Bëni një anketë në lagjen tuaj ku të pyesni njerëzit se cila, mendojnë ata, është ndotja më e keqe në Shqipëri. Me përgjigjet e marra bëni një grafik në formë torte. Përdorni të dhënat nga tabela e anketës.

Tema: Ndotja

Aktiviteti #: Tre

Aktiviteti: Të zotohemi se do të parandalojmë ndotjen

Materiale: Letër, letër poster, laps, ngjyra

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi



Keni studjuar llojet e ndryshme të ndotjes. Zgjidhni *një* lloj ndotjeje dhe bëni një poster për të informuar të tjerët për pasojat e dëmshme që ka ndotja. Së dyti, konceptoni një zotim që ju, familja dhe shokët tuaj do të merrni për të kundërshtuar pasojat e asaj lloj ndotjeje. Për shembull, nëse zgjidhni ndotjen e ajrit, edhe posterin duhet ta bëni për ndotjen e tij dhe ndikimin negativ që ka. Së treti, duhet të merrni zotimin për të ndihmuar që të mos ndotet ajri dhe njëkohësisht të caktoni edhe veprimin që do të bëni. Shkruajeni zotimin tuaj në një letër çertifikate si shembulli më lart dhe kërkoni që ta firmosin të gjithë ata që duan ta zbatojnë. Caktoni një afat dhe kontrolloni mbatjen e zotimit. A ka qenë e lehtë apo e vështirë? Thoni ç'ka qenë e lehtë dhe ç'ka qenë e vështirë.

Tema: Ndotja

Aktiviteti #: Katër

Aktiviteti: Të shkruajmë një vjershë apo këngë për ndotjen

Materiale: Lapsa, letër

Hapi fëmijë-fëmijë: Përsëritje

Mendoni për një ndotje që po dëmton seriozisht tokën tonë. A mund të bëni një vjershë apo këngë për ndotjen dhe ndikimin e saj në tokën tonë? Hë pra, provojeni! Jam e sigurtë që mundeni... Dhe do të dalë një këngë apo poemë shumë e bukur...

Tema : Ndotja

Aktiviteti #: Pesë

Aktiviteti: Tabela shkak-pasojë

Materiale: Laps e letër

Hapi fëmijë-fëmijë: Përsëritje

Mendoni për llojet e ndryshme të ndotjes që keni mësuar deri tani. Në fletën më poshtë shkruani emrin e një lloji ndotjeje. Më pas shkruani shkaqet dhe pasojat që sjell kjo ndotje në tokë, tek ne, njerëzit, dhe tek burimet natyrore të vendit tonë.

EMRI _____
DATA _____

Tabela shkak-pasojë

Shkaku është arsyeja pse diçka ndodh. Efekti është ajo që vjen si rezultat i shkakut. Identifikoni një ngjarje apo një çështje. Gjeni shkakun apo shkaqet duke pyetur pse pikërisht ndodhi kjo gjë?

Gjeni pasojën ose pasojat duke pyetur çfarë ndodhi si rezultat i ngjarjes? Kopjojeni këtë tabelë dhe plotësoni shkaqet dhe pasojat.

Shkakut e ndotjes

- Pasoje
- Pasoje

Shkakut e ndotjes

- Pasoje
- Pasoje

Shkakut e ndotjes

- Pasoje
- Pasoje

MBESHTETUR NGA:

UNICEF ALBANIA



THE CHILD TO CHILD TRUST



AMBASADA E MBRETERISE HOLLANDEZE



MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCES
INSTITUTI I KURRIKULES DHE TRAINIMIT



MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TE UJERAVE